

Nr. Prot. 042/B/15

VENDIM Nr. 697

Për

**Miratimin e tarifave për licencim për
ushtrim të veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve postare (one-off-fee) dhe
tarifës (taksës) së rregullt vjetore për licencë të operatorëve ofrues të shërbimeve postare**

Në mbështetje të neneve; neni 10 paragrafi (23), neni 79 paragrafi (2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, (*tutje; LKE*); nenit 6 paragrafi (1), nën-paragrafi (1.5) dhe nenit 26 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbime Postare (*tutje; Ligji*) dhe në përputhje me dispozitat e Rregullores së Brendshme të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje; Autoriteti ose ARKEP*), Bordi Drejtues (*tutje; BoD*) i Autoritetit në përbërje nga;

- 1) z. Ekrem HOXHA - Kryetar,
- 2) z. Besnik BERISHA - Anëtar,
- 3) z. Lulzim KURTAJ - Anëtar,
- 4) z. Naser SHALA - Anëtar,
- 5) z. Nijazi ADEMAJ - Anëtar,

në mbledhjen e LXXIII) të rregullt të mbajtur më datë; 09/10/2015, sipas procedurave të përcaktuara dhe objektivave të përcaktuara me Programin Vjetor të Punës për vitin 2015, mori në shqyrtim materialin shkresor (propozimin) dhe rekomandimin të përgatitur dhe paraqitur nga Sektori i Shërbimit Postar (*tutje; SSHP*), si dhe në referim të;

- i. Propozim kërkesës dhe rekomandimit të SSHP për ndryshim të Vendimit Nr. 80 me synim dhe objektiv uljen e tarifave të licencimit dhe thjeshtësimin e mëtutjeshëm të procesit dhe procedurave të raportimit të pasqyrave vjetore financiare nga ana e operatorëve të licencuar (*Referuar; pasqyrave financiare vjetore*);
- ii. Përafrimit të detyrimeve rregullatore në përputhje me praktikat e vendeve të rajonit;
- iii. Krijimit të kushteve sa më të favorshme për operim dhe lehtësimin e barrierave administrative dhe procedurave për konkurrencë në tregun e shërbimeve postare;
- iv. Zbatimin e përcaktimeve rregullatore ashtu si paraparë me legjislacionin në fuqi për sektorin e shërbimeve postare;
- v. Përmbushjen e detyrave dhe realizimit të Programit Vjetor të Punës për vitin 2015;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe si referuar më lartë, por edhe specifikave të marra në konsideruat nga autoritetit ligjor, BoD i Autoritetit, faktet dhe rrethanat si në vijim;

VËREHET se;

Dokumentacioni i arritur për shqyrtim dhe miratim nga BoD i Autoritetit, është i përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës nacional duke marrë në konsideratë të plotë specifikat e sektorit postar dhe për atë që sa e aplikueshme direktivat, rekomandimet dhe praktikat më të mira të shteteve të rajonit dhe Bashkimit Evropian dhe duke analizuar të dhënat sipas metodologjisë bazike dhe krahasimore me shtetet e rajonit, shtete fqinje të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të rrethanave faktike dhe ndryshimeve ligjore, ku kemi rastin që;

- a) Tarifat për licencim të operatorëve postar, krahasuar me ato të vendeve të rajonit janë më të larta dhe paraqesin një barrierë/kufizim për të hyrë në tregun e shërbimeve postare;
- b) Mënyra e raportimit të pasqyrave vjetore e vendosur sipas Vendimit Nr. 80 është vlerësuar se paraqet një kosto relativisht të lartë të shpenzimeve për auditimin e tyre krahasuar me nivelin e të hyrave të realizuara nga shumica e ofruesve të shërbimeve postare;
- c) Neni 6 paragrafi 1) nën-paragrafi (1.5) i Ligjit, e autorizon Rregullatorin (*Autoritetin*), që të përcaktoj tarifën për dhënie e licencave (*one-off-fee*) dhe tarifën e rregullt vjetore për ofrimin e shërbimeve postare, dhe afatet për kryerjen e pagesave;
- d) Neni 26 paragrafi 1) i Ligjit, i obligon operatorët postar të paguajnë taksën (tarifën) e rregullt vjetore për mbikëqyrje rregullatore, zyrës së Rregullatorit (*Autoritetit*);
- e) Neni 26 paragrafi 2) i Ligjit, parasheh mandatin ligjor të Autoritetit për nxjerrjen e këtij vendimi, përkatësisht përcaktimin e shumës, formës dhe afatet kohor të pagesës;

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

A T Ë H E R Ë;

Me qëllim të;

- 1) Përmbushjes së obligimeve rregullatore të Autoritetit në implementim të dispozitave të Ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi;
- 2) Uljen e tarifave për licencim më qëllim të lehtësimin të procedurave për të hyrë në treg dhe procedurave të raportimit të pasqyrave financiare; dhe
- 3) Krijimit të ambientit të përshtatshëm rregullator si paraparë me Programin Vjetor të Punës për vitin 2015, (*Ref. Synimi VIII*) – *Objektivi 2*).

V E N D I M

- I. Aprovohen tarifat për licencim të operatorëve postar (*one-off-fee*) për territorin e Republikës së Kosovës si në vijim;

Nr.	Lloji i licencës / shërbimit	Kohëzgjatja e Licencës	Tarifa €
1	Shërbime brenda RKS dhe Ndërkombëtare (V/N),	10 vite	1,500.00
2	Shërbime brenda RKS (Ekspres, Korrier, shërbime tjera), (V)	10 vite	1,000.00
3	Ndryshimi i të dhënave në Licencë (me kërkesë të palës),		100.00
4	Aplikimi për licencë,		50.00

- II. Aprovohet tarifa (taksa) e rregullt vjetore për mbikëqyrje të tregut të shërbimeve postare për të gjitha shërbimet postare të ofruara nga operatorët e licencuar postar, në lartësinë prej; **0.5 %**, sipas të hyrave dhe formës së raportimit të paraqitur në tabelën në vijim.

Nr.	Të hyrat vjetore	Forma e raportimit të pasqyrave financiare
1	Ndërmarrjet që kanë qarkullim deri 100.000,00 €	Zyrtari Kryesorë Financiar dhe dëshmi nga ATK;
2	Ndërmarrjet që kanë qarkullim nga 100.000,00 deri 1.000.000,00 €	Kontabilist i Certifikuar;
3	Ndërmarrjet që kanë qarkullim mbi 1.000.000,00 €	Auditor Certifikuar/Ligjor;

- III. Skema e re e tarifave të specifikuar në dispozitivin e nenit I) do të aplikohen nga hyrja në fuqi e këtij Aktvendimi dhe do të jenë të aplikueshme deri në nxjerrjen e një vendim të ri, ndërsa Autoriteti rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshoj këtë vendim, nëse e shoh të arsyeshme konform procedurave dhe përcaktimeve nga legjislacioni i aplikueshëm në Republikën e Kosovës.
- IV. Tarifat e specifikuar në dispozitivin e nenit II) do të aplikohen në baza vjetore duke filluar nga data; 01 Janar 2016 dhe atë në bazë të qarkullimit vjetor bruto nga veprimtaria e licencuar për vitin paraprak.
- V. Të gjithë operatorët postar, ofruet të shërbimeve postare janë të obliguar që Autoritetit, ti paraqesin (dorëzojnë) raportin vjetor të pasqyrave financiare ashtu si paraparë në nenin II) dhe atë JO më vonë se tre (3) muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal.
- VI. Të gjithë aplikantët për licencë, duhet të paguajnë një shumë të caktuar në emër të tarifës për procesim të aplikacionit. Shuma e tarifës për procesim të aplikacionit është pesëdhjetë euro (50.00 €) për të gjitha licencat individuale, përveç nëse është e

caktuar ndryshe nga organet kompetente sipas kushteve të pakosë tenderuese për tender publik.

VII. Ky vendim shfuqizon Vendimin Nr. 80 (Ref. ART Nr. Prot. 021/B/11, dt; 18/04/2011).

VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në ueb faqen zyrtare të Autoritetit; www.arkep-rks.org.

BAZA LIGJORE

Vendimi, mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar;

1. Neni 6 paragrafi 1) nën-paragrafi 1.5) i Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbime Postare;
2. Neni 26 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbime Postare;
3. Neni 5 paragrafi 1) nën-paragrafi 1.1) i U.A Nr. 05-2012 për licencimin e operatorëve postar;
4. Neni 8 paragrafi 3) U.A Nr. 05-2012 për licencimin e operatorëve postar;

Këshilla Juridike;

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Prishtine, 15/ 10/ 2015

Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Ekrem HOXHA
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet;

- Sektorit të Shërbimit Postar (SSHP) ARKEP;
- Gjithë operatorëve të licencuar të shërbimeve postare;
- Drejtorit të Departamentit të Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Arkivit, ARKEP